



A.K.P.A.
Nr. 2263/1 Prot.
Data me 16.09.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVESHKOLLA E
MESME PROFESIONALE "THOMAS PAPAPANO", GJIROKASTËR

Nr. 15/1 prot.

Gjirokastër, më: 16.09.2024

Lënda : Njohim për lëvizje paralele

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të Ligjit Nr. 15/2019 "Për ndalimin e Punësimit", Ligjit nr. 15/2017, "Për Arsimitin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.07.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të Udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të Arsimit dhe Formimit Profesional, si dhe Aspektet e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Përbërjes së Njesisë së Zhvillimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional", të Udhëzimit nr. 25, datë 01/09/2023 "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në Ofruesit e Arsimit Profesional".

Shkolla e mesme profesionale "Thoma Papapano" Gjirokastër, ju njofton krijimin e vendit të lire për pozicionin:

1. Dy mësues të Teorisë dhe Praktikës Profesionale, drejtimi TIK me kohë të pjesëshme,

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit

f) të demonstrojë aftësitë punës në grup dhe motivimin

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) Të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlefshme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruarit të AFP-së;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vite përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit.

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

a) Letër-motivimin për pozicionin;

b) Letërshkrimin (CV-në sipas shijeës I) (të udhëzimit 14 dt. 27.05.2021).

c) Kartën e identitetit;

d) Diplomën;

e) Librezën e punës;

f) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

g) Certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

h) Vërtetimin e gjëndjes shëndetësore;

h) Vërtetimin e gjëndjes gjyqësore;

j) Vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;

k) Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

l) Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

m) Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara;

n) Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruarit të AFP-së, 23.09.2024

DREJTOR

Renata Puleri

